

UDHËZIM
Nr. 1, datë 15.7.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 8, DATË 10.12.2010,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË
PROCEDURAVE TË DHËNIES TË SË DREJTËS SUBJEKTEVE JURIDIKE PËR
MARRJEN NË DISPOZICION TË SIPËRFAQEVE TË PARASHIKUARA PËR
NDËRTIMIN E OBJEKTEVE E ZHVILLIMIN E VEPRIMTARISË PËRKATËSE
NË ZONËN ENERGJETIKE DHE INDUSTRIALE TË PORTO-ROMANOS,
DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 3, të vendimit nr. 703, datë 23.4.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e studimit “Zhvillimi i integruar (në sinergji) i zonës energjetike dhe industriale të Porto-Romanos, Durrës, infrastruktura dhe konturet e saj””, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 8, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Ministria përgjegjëse për veprimtarinë energjetike dhe industriale, në vazhdim e quajtur “Ministria”, të informojë për zonat e përcaktuara për ndërtimin dhe përdorimin e objekteve energjetike dhe industriale, sipas skemës së vendosjes së tyre në hapësirat e përcaktuara me vendimin nr. 703, datë 23.4.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e studimit “Zhvillimi i integruar (në sinergji) i zonës energjetike dhe industriale të Porto-Romanos, Durrës, infrastruktura dhe konturet e saj””, në vazhdim i quajtur “Studimi”, si dhe për sipërfaqet për ndërtimin e tyre, sipas “Masterplanit”, të miratuar me vendimin nr. 2, datë 14.7.2009, të KRRTRSH-së.

Informimi të bëhet nëpërmjet publikimit të një materiali përmbledhës për “Masterplanin” dhe këtij udhëzimi në faqen e internetit të “Ministrisë”.”.

2. Pika 3 shfuqizohet.

3. Shkronjat “a” dhe “c”, të pikës 7, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) informacion mbi strukturën organizative të shoqërisë dhe NUIS;”.

“c) Kopjen e vendimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak ose njoftimin që projekti t’i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së, bazuar në Vlerësimin Strategjik Mjedisor, si dhe në studime e vlerësime mjedisore për “Zonën”.”.

4. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Trajtimi i kërkesave nga strukturat përgjegjëse të “Ministrisë”, si dhe realizimi i vlerësimit të tyre nga grupi i punës, i ngritur me urdhër ministri, bëhen brenda një periudhe jo më shumë se një muaj nga data e paraqitjes së kërkesës, si më poshtë vijon:

a) në përfundim të vlerësimit, në rastin kur ai konsiderohet i pranueshëm, i propozohet “Ministrit” t’i japë subjektit kërkuar “autorizimin” për vënien në dispozicion të sipërfaqes për ndërtimin e objektit dhe instalimin e teknologjisë përkatëse në zonën e kërkuar;

b) në rast se, sipas vlerësimit që i bëhet aplikimit të paraqitur nga subjekti, rezulton se shtrirja hapësinore, natyra dhe destinacioni i veprimtarisë së objektit që kërkohet të ndërtohet në një sipërfaqe të caktuar të “Zonës”, nuk janë sipas kushteve të “Masterplanit”, por objekti i përket fushave të energjetikës e industrisë dhe për këtë sipërfaqe nuk ka një propozim alternativ, sipas

kushteve të “Masterplanit”, dhe grupi i punës e vlerëson të pranueshëm këtë aplikim, në këtë rast i propozohet “Ministrit” që t’i japë subjektit kërkesë “autorizimin” për vënien në dispozicion të sipërfaqes për ndërtimin e objektit dhe instalimin e teknologjisë përkatëse në zonën e kërkuar sipas propozimit përkatës;

Dhënia e autorizimit duhet të bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data kur grupi i punës ka përfunduar vlerësimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti.

c) Në rast se pas përfundimit të vlerësimit rezulton se objekti, që kërkohet të ndërtohet dhe teknologjia që do të instalohet në të, nuk janë të fushave të energjetikës dhe të industrisë dhe nuk janë në përputhje me destinacionin e përcaktuar në “Masterplan”, grupi i punës i “Ministrisë” i paraqet “Ministrit” argumentimin e vlerësimit, duke propozuar që t’i kthehet subjektit praktika përkatëse, shoqëruar me arsyetimin për këtë qëndrim.

ç) Në rast se rezulton se subjekti nuk ka plotësuar qoftë edhe njërin nga kërkesat e pikës 7, të këtij udhëzimi, atëherë subjektit i kthehen dokumentet për plotësim.

Në rastin kur subjekti nuk është dakord me vlerësimin e “Ministrisë”, mund të bëjë ankim në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

5. Në pikën 10, fjalët “... brenda periudhës që bëhet vlerësimi i kërkesave ...” hiqen.

6. Shkronjat “b” dhe “dh”, të pikës 11, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“b) E drejta e subjektit për të investuar në zonën përkatëse, në përputhje me “Masterplanin”, duke identifikuar territorin për investim. Procedurat e dhënies së lejes së ndërtimit duhet të kryhen në përputhje me kërkesat e ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, si dhe të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij.”.

“dh) Marrëdhëniet me infrastrukturën portuale, të ndërtuar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi, si dhe me instalimet bregdetare për transportimin dhe depozitimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në “Zonë” (depozitat dhe tubacionet me pajisjet përkatëse), në rast se kjo është një kërkesë e teknologjisë që do të instalojë dhe do të përdorë subjekti.”.

7. Në pikën 12, shkurtimi “KRRTRSH” zëvendësohet me “KKT”.

8. Pika 16 ndryshohet si më poshtë vijon:

“16. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij udhëzimi.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama